

Ky hulumtim ka pasur për qëllim t'i analizoj këto pesë strategji në tri aspekte:

a) Sa është përmbushur Plani i Veprimit, në nivel të aktiviteteve?

b) Cilat janë sfidat dhe pengesat në zbatim të strategjive?

c) Sa kanë ndikuar këto dokumente strategjike në nxjerrjen e politikave apo vendimeve të reja nga qeveria apo institucioni bartës?

Të gjeturat e këtij hulumtimi tregojnë një nivel të ulët të zbatimit të pesë strategjive dhe sfida që nuk adresohen nga viti në vit dhe impakti i tyre në politikëbërje është i vogël.

Disa nga rekomandimet e D+ në këtë raport janë si në vijim: institucionet bartëse të strategjive t'iu përmbahen afateve kohore të përcaktuara në Plan të Veprimit për realizimin e aktiviteteve, t'iu japin përparësi atyre aktiviteteve me afat më të afërt kohor, si dhe t'iu evidentojnë aktivitetet të cilat nuk janë përmbushur në kohë, apo janë në proces.

Gjithashtu D+ rekomandon që Zyra për Planifikim Strategjik dhe institucionet tjera bartëse të strategjive të bëjnë më shumë presion te institucionet mbështetëse dhe të linjës për realizim të aktiviteteve dhe raportim mbi zbatimin e tyre.